



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 234

Tiranë – E mërkurë, 30 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 37, datë 24.12.2020	Për një ndryshim në aktin normativ nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e procedurës së përsheptuar për subvencionimin e pagesës së qirasë së banesës për familjet e mbetura të pastreha, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, tërmetit të datës 26.11.2019”..... 19945
Vendim i Këshillit të ministrave nr. 1099, datë 24.12.2020	Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore..... 19945
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1108, datë 28.12.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 143, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat për lëshimin e autorizimit, për subjektet e rindërtimit dhe për përjashtimin nga tatimi mbi vlerën e shtuar të furnizimit të mallrave e shërbimeve, për qëllime të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar..... 19964
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1116, datë 29.12.2020	Për dhënie ndihme financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Kroacisë, për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 29.12.2020..... 19965

**AKT NORMATIV**
Nr. 37, datë 24.12.2020**PËR NJË NDRYSHIM NË AKTIN
NORMATIV NR. 8, DATË 7.12.2019, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRDORIMIN E PROCEDURËS SË
PËRSHPEJTUAR PËR
SUBVENCIONIMIN E PAGESËS SË
QIRASË SË BANESËS PËR FAMILJET E
MBETURA TË PASTREHA, SI PASOJË E
FATKEQËSISË NATYRORE, TËRMETIT
TË DATËS 26.11.2019”**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Neni 7, i aktit normativ nr. 8, datë 7.12.2019, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 7

Subvencionimi i pagesës së qirasë, sipas këtij akti normativ, do të zgjasë deri në momentin që familjeve u rindërtohen apo rikonstruktohen banesat, të cilat, si rezultat i tërmetit të datës 26.11.2019, janë shembur ose janë deklaruar si të pabanueshme me akt konstatimi nga Instituti i Ndërtimit.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 1099, datë 24.12.2020**PËR MIRATIMIN E MËNYRAVE TË
TRAJTIMIT, NORMAVE TEKNIKE,
KRITEREVE DHE MODELEVE TË
NDËRHYRJEVE NË FUSHËN E
RUAJTJES SË PASURIVE KULTURORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 82, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kriterëve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore sipas rregullores, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Objekt i këtij vendimi janë të gjitha pasuritë kulturore, të shpallura si të tilla në bazë të legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore, të fushave të arkitekturës, arkeologjisë dhe veprave të artit, fushës së librit dhe dokumenteve arkivore, që i përkasin personave fizikë, juridikë, privatë apo publikë, me qëllim mbrojtjen, ruajtjen, konservimin dhe restaurimin e tyre.

3. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtën kuptim si në ligjin nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

4. Vendimi nr. 426, datë 13.7.2007, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen institucionet e specializuara, sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, si dhe subjektet e licencuara për ndërhyrje në pasuritë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

**RREGULLORE****PËR MËNYRAT E TRAJTIMIT, NORMAT TEKNIKE, KRITERET DHE MODELET E NDËRHYRJEVE NË FUSHËN E RUAJTJES SË PASURIVE KULTURORE****I. MËNYRAT E TRAJTIMIT TË PASURIVE KULTURORE**

1. Pasuritë kulturore konsiderohen dëshmi të kohës së tyre, të marrëdhënieve shoqërore, të nivelit tekniko-material të shoqërisë dhe ndërtuesve dhe të individualitetit të krijuesit. Asnjë epokë e mëvonshme nuk mund të ketë të njëjtët përbërës për të krijuar të njëjtën vepër. Pasuritë kulturore përbëjnë dokumente shkencore me vlera të mëdha për studimin dhe dokumentimin e historisë.

2. Trajtimi i pasurive kulturore, një aktivitet shumëdisiplinor, duhet të paraprihet nga hulumtime të mirëfillta kërkimore e teknike.

3. Në trajtimin e pasurive kulturore ndikojnë kriteret në bazë të të cilave është realizuar procesi i deklarimit të pasurisë kulturore duke konsideruar kështu kriterin gjinor dhe tipologjik, faktin nëse kemi të bëjmë me një shembull të vetëm e të rrallë, kriterin e autenticitetit, kriterin e vlerave arkitektonike, kriterin kohor, kriterin e shpërndarjes hapësinore të dukurisë arkitektonike apo ndërtimore si dhe kriterin e bashkëjetesës së vlerave arkitektonike me vlerat artistike.

4. Termat e përdorur në këtë vendim si: “konservimi paraprak”, “konservim i integruar”, “mirëmbajtja”, “parandalim”, “restaurim”, “ruajtja”, “ruajtje të trashëgimisë jomateriale” “ruajtja e objekteve muzeore”, kanë të njëjtin kuptim me termat e parashikuar në nenin 5, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”. Termat e tjerë të përdorur në vendim kanë kuptim si vijon:

a) “Patina/cipa e kohës” është shtresa që krijohet në sipërfaqe të materialit të ndërtimit si gurë apo tulla si pasojë e vjetërsisë dhe kohës. Ajo duhet ruajtur për arsye historike, estetike, teknike dhe për funksionet e saj mbrojtëse ndaj gjërryerjes e cila fillon nga sipërfaqja e objektit.

b) “*Ex novo*” është ndërhyrje me një element të ri ndërtimor apo në vepër arti. Në përgjithësi integrimi i elementeve *ex novo* në pasuritë kulturore nuk është i këshilluar.

5. Mënyrat e trajtimit të lejuara gjatë procesit të ruajtjes, konservimit dhe restaurimit të pasurive kulturore janë:

a) plotësimi i pjesëve të munguara, në funksion të qëndrimit statik dhe të riintegritetit të pjesëve të vogla, të vërtetuara historikisht, në atë pozicion, duke evidentuar në mënyrë të qartë kufirin mes pjesës së plotësuar, por edhe duke adaptuar material të ndryshëm nga origjinali, të aprovuar, të dallueshëm me sy të lirë, në veçanti në pikat e takimit me pjesët si dhe në rastet e një motivi dekorativ, motiv floreal dhe gjeometrik, që është riprodhim i së njëjtës formë dhe linja është e qartë. Plotësimet duhet të jenë në çdo rast të dallueshme nga pjesa origjinale, si dhe të sigluara dhe datuara aty ku është e mundur; gjykimi për plotësim duhet të vendoset nga ana e ekspertit restaurator, në konsultë me ekspertë të tjerë të së njëjtës fushë;

b) procesi i pastrimit të materialit ndërtimor apo veprës, i cili duhet të marrë në konsideratë respektimin e patinës së kohës. Në rastin e pikturave dhe skulpturave polikrome, pastrimi nuk duhet të arrijë kurrë deri te ngjyra, duke respektuar patinën dhe bojën origjinale;

c) rikompozimi i veprave të copëtuara, sistemimi i veprave me pjesë të mangëta, duke bërë rigrupime të fragmenteve dhe të masave a pjesëve të dobëta, me një teknikë të dukshme për syrin e lirë, me zona neutrale të vendosura në nivel të ndryshëm nga ai i pjesëve origjinale ose duke vënë në pah suportin origjinal, por duke mos integruar asnjëherë një *ex novo* në zona me figurina dhe ndërfutur elemente që përcaktojnë figuracionin e veprës;

ç) modifikimi dhe ndërhyrjet e reja me qëllim qëndrueshmërinë statike dhe ruajtjen e strukturës së brendshme, vetëm kur këto nuk ndikojnë në pamjen përfundimtare dhe kur pas përfundimit të ndërhyrjes nuk rezultojnë ndryshime kromatike apo sipërfaqësore ose vëllimore;

d) vendosja në një hapësirë tjetër, të sigurt ekspozimi, në rastin kur konteksti *in situ* nuk ekziston më apo, në rast se kushtet e konservimit nuk mund të përmbushen.

6. Mënyrat e trajtimit të ndaluara gjatë procesit të ruajtjes, konservimit dhe restaurimit të pasurive kulturore janë:

a) plotësimet, bazuar në stil, ngjashmëri objekti apo hipoteza edhe kur këto kryhen me qëllim prezantimi më të plotë estetik të objektit apo për të



treguar si mund të ketë qenë pamja e kësaj pasurie kur është krijuar në portrete dhe në skena komplekse, kryesisht në ndërtime kulturi dhe ikona;

b) ndërhyrjet ose plotësimet, që fshijnë gjurmët e kalimit të pasurisë kulturore nga një periudhë në tjetrën, ose plotësimet në stil që falsifikojnë veprën;

c) ndërhyrje rindërtimi ose zëvendësimi në vende të ndryshme nga ata të origjinës. Kjo mund të ndodhë, vetëm nëse është e detyrueshme nga arsye madhore, për shkak të procesit të konservimit;

ç) ndërhyrje *in situ*, si p.sh. të kompleksit monumental ose ambientit, kompleksit të mobilimit, kopshtit, parkut;

d) ndryshime ose tjetërsime cipash/patine;

dh) rikuperimi i një relikeje të një anije të mbytur nga uji nuk duhet të fillojë para se të parapërgatitet vendi dhe të jenë siguruar aparaturat e nevojshme që lejojnë zbulimin e materialeve që do të rikuperohen nga fundi i detit apo i liqenit, si dhe pasi të jenë parashikuar të gjitha trajtimet e mëvonshme speciale, që kërkojnë para së gjithash pjesët e drunjtë, nëpërmjet larjeve të vazhdueshme, me substancë speciale konsolidante në ambiente dhe temperaturë të kondicionuar dhe trajtime të tjera të nevojshme konservuese.

e) për sa i përket konsolidimit të materialeve arkitektonike dhe të skulpturave të zbuluara nga gërmime arkeologjike dhe të ekspozuara në ambient të hapur, duhen evituar eksperimentimet me metoda që nuk kanë dhënë rezultate të mira, pasi mund të sjellin dëme të pakthyeshme.

7. Përdorimi i mënyrave, teknikave dhe materialeve të reja në ndërhyrjet në pasuritë kulturore bëhet me autorizimin e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale “KKTKM”, i cili merr vendim konform gjykimit të institucioneve të specializuara shtetërore, të cilat duhet të promovojnë metodat dhe lëndët e reja, duke mos këshilluar në asnjë rast, lëndë dhe metoda të vjetruara, të dëmshme, jo të kolauduara, në:

a) mënyrat e ndërhyrjes dhe materialet e traditës/origjinale të pasurive kulturore dhe koleksioneve muzeale;

b) përdorimin e metodave dhe materialeve të reja të konservimit, konsolidimit në pasuritë kulturore dhe koleksionet muzeale.

8. Masat për mbrojtjen nga agjentët atmosferikë, termikë dhe higrometrikë në funksion të ruajtjes së pasurive kulturore duhet të jenë, të tilla që:

a) të mos tjetërsojnë pamjen dhe ngjyrën e sipërfaqes së objektit apo të ndikojnë në modifikimin dhe ndryshimin thelbësor e të përhershëm të kontekstit ambiantal në të cilin veprat janë përcjellë historikisht;

b) në rast modifikimesh, me qëllim ruajtjen, konservimin, konsolidimin dhe restaurimin e objekteve, ato kryhen duke evituar çdo lloj cenimi në pamjen e objektit dhe në ambientin në të cilin ai është përshtatur;

c) në rast të ndërhyrjeve të papërshtatshme në pasuritë kulturore, të kryera në kohë, të cilat kanë cenuar apo rrezikojnë të cenojnë vlerat historiko-kulturore të tyre, duhet të vlerësohet mundësia e ndërhyrjeve për kthimin në gjendjen e mëparshme, në përputhje me dokumentacionin historik të veprës;

ç) në çdo rast, marrja e masave për restaurimin dhe konservimin e pasurive kulturore arkeologjike duhet studiuar në raport me nevojat e ndryshme klimatike në ambiente të ndryshme ekspozimi apo ruajtje.

II. NORMAT TEKNIKE TË NDËRHYRJEVE NË PASURITË KULTURORE

1. Trajtimi i objekteve dhe i *site*-ve të trashëgimisë kulturore nëpërmjet punimeve mirëmbajtëse, projektimit dhe zbatimit të punimeve të konservimit dhe restaurimit kërkon studimin dhe analizimin e gjendjes statike dhe të konservimit, përcaktimin e shkaqeve konkrete të dëmtimeve, si dhe përcaktimin e mënyrës së konservimit dhe restaurimit të tyre. Marrja parasysh e disa normave teknike bazë ndihmon në proceset e studimit, diagnostikimit, projektimit dhe zbatimit të punimeve të konservimit dhe të restaurimit, të cilat përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për studimin, projektimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e ndërhyrjeve në pasuritë kulturore”.

2. Normat teknike të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore ndahen sipas fushave të mëposhtme:

a) Arkeologji;

b) Arkitekturë;

c) Vepra arti;

ç) Hapësira urbane/rurale;

d) Libri;

dh) Materiale arkivore.



A. Norma teknike të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore arkeologjike

1. Mbrotjtja e nëntokës arkeologjike është e lidhur me një sërë dispozitash ligjore që kanë të bëjnë me shpronësimet, aplikimin e detyrimeve të veçanta, krijimin e parqeve arkeologjike. Në bashkëshoqërim të masave që duhen ndërmarrë në raste në ndryshme do të jetë gjithnjë njohja e kujdesshme e terrenit, për të mbledhur të dhëna të dukshme në sipërfaqe, materiale qeramike të shpërndara, dokumentim të elementeve që vërtetojnë mbetje arkeologjike. Marrja e kampioneve të gërmimit nëpërmjet zbulimit të themeleve duhet të realizohet pa i dëmtuar ato dhe strukturën që ato mbajnë. Operacionet duhet të udhëhiqen nga zbatimi i metodave bashkëkohore të njësive stratigrafike, metoda të cilat mund të ofrojnë të dhëna të vlefshme për ngjarjet dhe fazat në të cilat ka kaluar monumenti.

2. Gjatë kryerjes së gërmimeve duhet të garantohet pjesëmarrja e restauratorëve që në ndërhyrjen e parë të rikuperimit dhe fiksimit. Vëmendje e veçantë i duhet kushtuar problemit të restaurimit të veprave të artit të destinuara për të mbetur ose për t'u rivendosur nëse hiqen, në vendin origjinal, veçanërisht kjo për pikturat dhe mozaikët.

3. Përdorimi i mënyrave, si: fotografimi nga ajri, marrja e pikave me GPS dhe identifikimi i zonave përkatëse në një bazë të dhënash GIS, hulumtimet përmes metodave gjeofizike, ndihmojnë në njohjen sa më të plotë të natyrës arkeologjike të terrenit, në aplikimin e normave të mbrojtjes së natyrës, në detyrimin për përpilimin e planeve rregulluese, si dhe për mbikëqyrjen në rastet e realizimit të ndërtimeve të reja.

4. Për mbrojtjen e pasurisë arkeologjike nënujore nga projektet zhvillimore/transformuese dhe nga kërkimet nënujore që cenojnë *site*-t arkeologjike nënujore, reliket e anijeve antike dhe ngarkesat e tyre, rrënojat dhe skulpturat e fundosura, është e detyrueshme marrja e masave të veçanta, si vijon:

a) Krijimi i hartës arkeologjike nënujore, “Regjistri detar” me indikacione unifikuar të dhënat e përfituara ndër vite si rezultat i veprimtarisë së institucioneve të specializuara të fushës si dhe ato të raportuara i gjetje rastësore. Këto të dhëna i bashkëngjiten platformës Web-GIS të IKTK-së, me qëllim si mbrojtjen e tyre

ashtu edhe programimin e kërkimeve shkencore nënujore.

b) Eksplorimi i bregdetit shqiptar nga IKTK-ja mund të kryhet në kuadër të mbikëqyrjes së projekteve zhvillimore/transformuese, planeve të zgjerimit strategjik të FA-së, gjurmimit të gjetjeve rastësore, si pasojë e aktivitetit të peshkimit ose një fakti çfarëdo, si dhe ndërhyrjeve të paautorizuara.

c) Krijimi i zonave arkeologjike nënujore me kufij të përcaktuar dhe rregullore përkatëse, si dhe shpallja e *site*-ve arkeologjike për ato zona që tashmë janë të identifikuar.

ç) Bashkëpunimi i ngushtë me Autoritetin Portual, Flotën Detare, si dhe Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të cilat përveçse shtrijnë fushën e veprimtarisë së tyre në ujërat e bregdetit shqiptar, janë njëkohësisht identifikuesit më potencial të pasurisë arkeologjike nënujore dhe parandaues të dëmtimeve të mundshme nga klandestinët.

5. Mënyrat e nxjerrjes dhe e rikuperimit nga uji të anijeve të mbytura, studiohen rast pas rasti, në varësi të gjendjes dhe veçantisë së relikes, duke pasur parasysh eksperiencat ndërkombëtare. Në këto lloje specifike kërkimesh dhe gjetjesh, ashtu si dhe në eksplorimet arkeologjike tokësore duhet të përshtaten metoda speciale për konservimin dhe restaurimin e objekteve, sipas llojit dhe lëndës së tyre.

6. Për materialet e qeramikës dhe amforat merren të gjitha masat që lejojnë identifikimin e mbetjeve ose gjurmëve të mundshme, të dhëna të vlefshme për historikun e tregtisë së kryer dhe mënyrën e jetës në antikitet. Vëmendje e veçantë u kushtohet fiksimit të përshkrimeve të pikturave, sidomos atyre mbi trupin e amforave. Për sa i përket qeramikës dhe terakotës nuk kryhen lavazhe dhe pastrime të nxituara, kur ka prezencë të pikturave, shkrime, bojëra. Kujdes i veçantë duhet bërë edhe në mbledhjen e objekteve ose fragmenteve të metalit, veçanërisht atyre të oksiduara, duke punuar si me mënyrat moderne të konsolidimit ashtu edhe me suporte speciale.

7. Në rastin e elementeve të shpërbëra të dekoracioneve në stuko, në pikturë, në mozaik ose në *opus sectile* është e nevojshme që para dhe gjatë lëvizjes së tyre, këto elemente të mbahen të bashkuar, me garza dhe me ngjitës të përshtatshëm, në mënyrë që më vonë të lehtësohet rikompozimi dhe restaurimi në laborator.



8. Në rastin e zbulimit nga nëntoka të objekteve prej qelqi nuk duhet të kryhet asnjë pastrim gjatë operacionit të zbulimit, pasi janë objekte mjaft delikate.

9. Në rastin e zbulimit nëpërmjet gërmimit të veprave të artit, si piktura dhe mozaikë duhet të mbahet parasysh ndërhyrje me lloje të ndryshme të suportesh, mbajtësesh kornizash dhe ngjitësish, në përputhje dhe varësi me kushtet klimatike, atmosferike dhe higrometrike, që për pikturat lejon përshtatjen në ambiente të favorshme të mbuluara, të një ndërtese antike, duke evituar kontaktin direkt me sipërfaqen e murit dhe duke realizuar kështu një montim dhe konservim të sigurt. Duhet evituar, gjithashtu, përdorimi i bojërave ose i dyllit për të theksuar ngjyrat, pasi kjo mënyrë mund të bëhet shkak për ndryshim të pamjeve të origjinalit. Në të tilla raste mjafton vetëm një pastrim i sipërfaqeve origjinale.

10. Për restaurimin e strukturave të punuara me teknikë kuadratike është eksperimentuar me sukses rikrijimi i blloqeve në përmasat antike, duke përdorur grimca pjesë nga materiali origjinal, të çimentuara dhe në sipërfaqe me llaç të përzier me pluhur të materialit origjinal, për të arritur intonacionin kromatik. Në disa raste këshillohet një trajtim i ndryshëm sipërfaqësor me materiale të reja, si dhe me gdhendje të përshtatshme. Në fund është e nevojshme të vendosen në çdo zonë të restauruar pllakëza me datën, siglën ose shenja dalluese të veçanta.

11. Në ngjitjen e blloqeve dhe kolonave antike prej mermeri, shtufi ose gëlqereje, mund të rezultojë i nevojshëm përdorimi i çimentos në sipërfaqe të riveshura me pluhur nga materiali i monumentit që restaurohet, duke marrë në konsideratë tonin konciz në raport me monumentin. Në ambiente të lidhura me kulturën romake, mermeri i bardhë mund të integrohet me travertinë ose gëlqeror, duke iu referuar eksperimenteve të kryera deri tani. Në monumentet antike dhe veçanërisht ato të epokës arkaike ose klasike duhet evituar afrimi i materialeve të ndryshme dhe anakronike në pjesët e restauruara, sepse rezultojnë “ofensiv” nga këndvështrimi kromatik, ndërkohë që mund të përdoren zgjidhje me materiale me të cilat është konstruktuar vetë monumenti.

12. Problem specifik për monumentet antike janë mbulesat e mureve të dëmtuara dhe mbi të

gjitha mbajtja e linjës së dhëmbëzuar të rrënojës. Për këtë arsye, në monumentet antike përdoret një shtresë argjilë e përzier me pluhur qeramike. Kjo metodë jep rezultate të mira në këndvështrimin estetik dhe rezistencës ndaj agentëve atmosferikë.

B. Norma teknike të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore arkitektonike

1. Restaurimi i materialeve të përdorura në monument:

a) Gjatë procesit të projektimit dhe zbatimit të punimeve konservuese/restauruese i duhet dhënë rëndësi e veçantë ruajtjes për një kohë sa më të gjatë të materialeve origjinale të përdorura për ndërtimin e strukturave dhe elementeve të veçanta të monumentit. Marrja e masave për zgjatjen e jetës së tyre realizohet në dy mënyra:

i. duke përforcuar në vetvete secilin nga materialet përbërës;

ii. duke mënjанuar shkaqet që sjellin degradimin e shpejtë të materialeve.

b) Në rast se mënyra e parë nuk arrin të realizohet apo materiali paraqitet i degraduar në masën që nuk arrin më të kryejë funksionin e tij, duke rrezikuar strukturat, rruga tjetër në restaurim është zëvendësimi i materialeve të vjetra e të degraduara me materiale më të reja, të së njëjtës natyrë ose jo, sipas gjykimit të rastit të dhënë. Kjo rrugë duhet të shkelet vetëm në fund.

c) Në çdo rast, duhen marrë masa për mënjanimin apo eliminimin e shkaqeve që shkaktojnë degradimin e materialeve.

ç) Materiale bazë të traditës që përdoren në ndërtimet në Shqipëri janë guri, materiale qeramike, llaçi, druri dhe metali.

2. Restaurimi i gurit:

a) Guri mund të quhet materiali më i përdorur në ndërtimet e traditës në Shqipëri. Për mënjanimin e dëmtimeve në materialin e gurtë duhet të merren një sërë masash, si për evidentimin e shkaqeve që shkaktojnë degradimin dhe të pasojave. Ndër shkaqet kryesore të dëmtimit janë:

i. uji, i cili ndër veprimet fizike, është në themel të gati gjithë dëmtimeve. Lëvizja e ujit në lëndën e gurit është në varësi të porozitetit, kapilaritetit dhe përshkueshmërisë;

ii. temperatura, e cila shkakton dëmtime në materialin e gurtë si rezultat i bymimit jo të njëjtë të kristaleve në drejtime të ndryshme;



iii. përbërja e ajrit; era me shi e pluhur vepron në materialin e gurtë duke dëmtuar sipërfaqen e ekspozuar;

iv. ngarkesat e përqendruara, nën veprimin e të cilave gurët në muraturë mund të paraqesin dëmtime si pasojë e shtresëzimeve paralel me ngarkesat, si pasojë e pranisë së fugave me llaç që përqendrojnë ngarkesat dhe si pasojë e shpërndarjes jo të mirë të fugave/llačit;

v. dëmtimet për shkaqe kimike, të cilat vijnë nga veprimi kimik i materialeve të ndërtimit dhe të gazrave të atmosferës;

vi. dëmtimet për shkaqe biologjike, bakteret e depozituara në poret e sipërfaqes mund të shkaktojnë dëmtime të cipës së gurit;

vii. defekte natyrore në strukturën e materialit, si pasojë e shtresëzimeve me veti të ndryshme fiziko-kimike apo çarje të padukshme.

b) Pas evidentimit të shkaqeve të dëmtimit duhet të ndërmerren masa për parandalimin apo mënjanimin e pasojave, si dhe ruajtjen e gurëve të vjetër/origjinalë të strukturave, si më poshtë:

i. mënjanimi i lagështisë që vjen nga toka nëpërmjet drenazhimit dhe tharjes së mureve;

ii. procesi i pastrimit të gurëve duhet të realizohet pas mënjanimi të lagështisë dhe pas shmangies së mundësisë së lëvizjes së kripërave nëpërmjet ujit që qarkullon në poret e materialit. Procesi i pastrimit mund të jetë fizik ose kimik dhe përfshin larjen, pastrimin mekanik të gurit dhe mbrojtjen e pjesëve të pastruara. Në çdo rast, pastrimi duhet të marrë në konsideratë ruajtjen e cipës/patinës së kohës dhe të mos ndikojë në tjetërsimin e pamjes apo të përbërjes së materialit të vjetër/origjinal të gurit;

iii. përforcimi i materialit të gurit me anë të imprenjimit me solucionë, të cilat janë në formë pak a shumë viskoze duhet fokusohet në marrjen e masave në pikat “j” dhe “k” si dhe të sigurojë të mos shkaktojë sipërfaqe të papërshkueshme të gurit;

iv. zëvendësimi i gurëve të vjetër/origjinal të strukturave duhet konsideruar me shumë maturi dhe vetëm kur gjykohet si rast i fundit dhe i domosdoshëm për qëndrueshmërinë statike të të gjithë strukturës. Në këto raste gurët e rinj, që zëvendësojnë të vjetrit, duhet të jenë të po asaj natyre, si dhe lidhja e tyre me muraturën duhet të bëhet me material lidhës të po së njëjtës natyrë apo të përshtatshëm me lidhësin e vjetër;

v. Cipa/patina e gurëve duhet ruajtur për arsye historike, estetike, teknike dhe për funksionet e tij mbrojtëse ndaj gërryerjes e cila shpesh dihet fillon nga sipërfaqja e objektit. Lëndët e akumuluar mbi gurë-depozitime, pluhura, blozë, pastrohen duke përdorur furça organike ose presion ajri apo avulli të moderuara. Ndalohet përdorimi i furçave metalike, krueset dhe nuk aplikohen presione ajri të forta me rërë natyrore, ujë apo avull.

3. Restaurimi i materialeve të ndërtimit prej qeramike:

a) Tullat dhe tjegullat përbëjnë materialin bazë të ndërtimit në mjaft monumente të arkitekturës në vendin tonë. Përgjithësisht, këto materiale i qëndrojnë shumë mirë kohës, por në mjaft raste ato dëmtohen si pasojë e:

i. pjekjes jo të mirë, e cila shkakton rezistencë të vogël të tyre dhe dëmtime si ciflosje dhe pluhurizim të sipërfaqes nga ndryshimet e temperaturës dhe ngricat;

ii. praninë në to të kripërave të tretshme e cila shkakton efloreshencën, rezultat i daljes së kripërave në sipërfaqe në formë njollash me ngjyra të ndryshme;

iii. lyerjes me ngjyra të ndryshme pa respekt për monumentin, të muraturës me tulla të pasuvatuara, më e shpeshta nga të cilat është sherbeti i gëlqeres.

b) Masa e parë për pastrimin e materialeve të ndërtimit prej qeramike është mënjanimi i lagështisë për kapilaritet. Kur efloreshencat janë shkaktuar nga materiale organike, sipërfaqja lahet me solucion 5–10% të acidit klorhidrik dhe shpëlahet me ujë të pastër. Efloreshencat e tjera mënjanojnë me fshirje me furçë dhe larjen e murit. Në rastet kur ndërtesat me muraturë tullash të pasuvatuara paraqiten të lyera, zgjidhet pastrimi mekanik. Në asnjë rast nuk duhet rrezikuar dëmtimi pa arsye i sipërfaqes së vjetër të tullave.

c) Tjegullat janë materiali që më shpesh ripërtërihen gjatë rindërtimeve apo riparimeve të çatave. Në këto raste, tjegullat e reja duhet të jenë përgatitura me kujdes me të njëjtat përmasa dhe formë me të vjetrat, si me argjilë të stazhionuar ashtu dhe të pjekura mirë.

4. Restaurimi i llaçit dhe i suvetimeve:

a) Llaçi përbën një nga materialet bazë në ndërtesa, nga qëndrueshmëria në kohë e të cilit varet dhe qëndrueshmëria e strukturave. Ndërhryjet në këtë material realizohen me qëllim përforcimin e strukturave apo përdorimin e llaçit



gjatë ribërjes së pjesëve të veçanta të muraturës gjatë restaurimit plotësues apo atij përforcues;

b) Përdorimi i çimentos në përbërjen e llaçit në ndërhyrjet në pasuritë kulturore nuk është e këshillueshme, pasi bie ndesh me kriterin e kthyeshmërisë, si dhe mund të shkaktojë efloreshencë në kontakt me materialin e qeramikës, si dhe në praninë e pikturave murale në muraturë. Përdorimi i gëlqeres së shuar në përputhje me rregullat teknike dhe stazhionimi i saj për një kohë të gjatë mund të zëvendësojë mjaft mirë çimenton;

c) Në ndërhyrjet për përforcimin e llaçit të vjetër përdoret injektimi i përbërjeve të llaçit apo rrëshirave sintetike. Në këto raste përbërja e llaçit të përdorur duhet të zgjidhet në zbatim të kriterëve të përputhshmërisë dhe të kthyeshmërisë.

5. Restaurimi i strukturave:

a) Për vetë kohën e gjatë të ekzistencës së pasurive kulturore, në strukturat ndërtimore që i përbëjnë, shfaqen dëmtime nga më të ndryshmet që kërkojnë ndërmarjen e ndërhyrjeve përforcuese, me qëllim ridhënien e aftësive mbajtëse dhe krijimin e strukturave të reja që i lehtësojnë të vjetrat apo marrin tërësisht ngarkesat në to.

b) Strukturat mbajtëse në pasuritë kulturore të fushës së arkitekturës janë:

- i. themelet;
- ii. strukturat vertikale – muret, harqet, qemerët dhe kupolat;
- iii. strukturat horizontale - tavanet dhe dyshemetë;
- iv. çatia.

c) Në varësi të materialeve të ndërtimit dhe tipareve strukturore të tyre ndërhyrjet në to paraqiten me veçantitë e tyre.

5.1 Restaurimi i themeleve:

a) Themelet që përdoren në pasuritë kulturore me muraturë janë kryesisht dylojeshe: të vazhduara ose të veçanta. Në rastet kur ndërtimet janë në terren të dobët dhe në prani të ujit, janë përdorur dhe pilotat apo vendosja e trarëve nën themelin tërthor të tyre për të shtuar sipërfaqen e mbështetjes në taban. Dëmtimet e shkaktuara në themele mund të vijnë si rezultat i themeleve të cekëta dhe të ndërtuara mbi taban, që nuk përballon ngarkesat, si pasojë e mosnjohjes së situatës hidrogeologjike të terrenit apo ndryshimit të këtyre vetive në një kohë të mëvonshme, rritja e ngarkesave gjatë ndryshimeve që kanë pësuar

pasuritë kulturore, si dhe ndryshimit të kontekstit përreth pasurisë kulturore si ndërtime të reja, transport rrugor, vibrime;

b) Pas përcaktimit të saktë të shkakut të dëmtimit të themeleve dhe mbistrukturave mund të merren masa të cilat nuk kërkojnë goditje në tokë, si:

i. përforcimi i terreneve poroze, ranore, zhavorrishte dhe shkëmbore me çarje me anë të injektimeve apo ndërtimit të pilotave;

ii. përforcimi i themeleve nëpërmjet përforcimit të muraturës me anë të injektimit, zgjerimit të sipërfaqes mbështetëse të themelit mbi bazën e ngarkesave dhe rezistencës së terrenit, veshja e themeleve me këllëf betonarmeje apo nëndërtimit të themeleve në rast të terreneve të dobëta përforcimi i të cilave paraqitet me vështirësi;

c) Gjatë përforcimit të themeleve, kur ka dhe struktura të mureve dhe qemerëve të dëmtuara, duhet të ndërmerret përforcimi i tyre paraprak për të pasur siguri në vazhdimin e punës dhe për të mënjeluar dëmtimet e mëtejshme të strukturave. Para përforcimit të themeleve duhet të kryhet studimi arkeologjik i zonës.

ç) Përdorimi i betonit në përforcimin e themeleve apo ndërtimi i themeleve të reja prej betoni duhet të shmanget sa më shumë për të lejuar studimin e strukturave në të ardhmen, si dhe në zbatim të parimit të kthyeshmërisë.

5.2 Restaurimi i muraturës:

a) Dëmtimet në muraturë mund të shkaktohen nga shkaqe të ndryshme, si:

- i. ulje jo të njëtrajtshme të terrenit;
- ii. veprimi i agentëve të jashtëm;
- iii. mbingarkesa;
- iv. veprimi i forcave të natyrës;
- v. vjetrimi i materialeve të strukturave;
- vi. shkaqe njerëzore si ndryshime, shtesa.

b) Muratura në radhë të parë duhet t'i nënshtrohet mirëmbajtjes së vazhdueshme, me qëllim mënjanimin e dëmtimeve të mëtejshme dhe përforcimin e elementeve përbërëse, si gurët dhe tullat. Në çdo rast, duhet të përcaktohet shkakut i dëmtimit para fillimit të ndërhyrjes, si dhe përforcimi i mureve duhet të paraprihet nga përforcimi i tabanit dhe themeleve, sipas nevojës. Përpara trajtimit të muraturës duhet të merren masa për sigurinë mbi ekzistencën ose jo të çfarëdolloj gjurme dekoracioni apo afresku në origjinë të veprës poshtë suvatimeve të mundshme.



Kjo mund të bëhet nëpërmjet sondazheve në pjesë të ndryshme apo zhveshjes së muraturës nga suvatimet.

c) Ndër masat e marra për përforcimin e muraturave është:

i. drejtimi i mureve të pjerrëta, nëpërmjet tërheqjes apo shtytjes, e cila realizohet vetëm pas përforcimit të tij me armaturë dërrase;

ii. rivendosje e lidhjeve në brendësi apo përforcimi i lidhjeve të dëmtuara, me anë të injektimit të lidhësit përforcues në brendësi.

ç) Ruajtja e materialit dhe strukturës së vjetër/originale të muraturës duhet të jetë parimi udhëheqës i ndërhyrjes, duke lënë ribërjen e muraturave si zgjidhje të fundit, në rast se nuk ka rrugë tjetër. Kur zgjidhja e detyruar është ribërja pjesore e mureve me gurë apo tulla, ndërhyrjet duhet t'u përmbahen me saktësi kriterëve të restaurimit, si dhe të zbatohen me rreptësi rregullat teknike për lidhjen e pjesës së vjetër me të renë, si dhe të mbushjes së fugave të prishura, në mënyrë që të zgjatet më shumë jeta e muraturës. Zëvendësimet dhe bashkimet eventuale të veshjeve të jashtme të mureve, duhet të bëhen në limite të përcaktuara qartë dhe të jenë të dallueshme nga elementet e tjera origjinale. Zakonisht preferohet të operohet përgjatë periferisë së bashkimit me një shenjë të qartë dhe të dallueshme të ndërhyrjes.

d) Ndërhyrjet për përforcimin e strukturave të muraturave, me qëllim mënjanimin e rreziqeve, si pasojë e lëkundjeve sizmike, duhet t'u përmbahen normave teknike në territorin e Shqipërisë, sipas llojit të ndërtesës, duke u kujdesur të mos dëmtohen apo cenohen pjesët me vlerë të pasurisë kulturore.

dh) Në mjaft raste përdoren përforcime të përkohshme, si masë e parë, me qëllim parandalimin e dëmtimit të mëtejshëm apo rrëzimit të mureve, murosja me material të dobët e hapësirave të dyerve dhe dritareve për shmangien e rënies së arkitrarëve apo të harqeve që i mbulojnë ato, nëpërmjet ndërtimit të kundërforcave për të mos lejuar rrëzimin e mureve të pjerrëta dhe për të përballuar shtytjet e mbulesave me qemerë deri në marrjen e masave përfundimtare restauruese. Këto masa duhen shoqëruar me lehtësimin e ngarkesave të muraturës mbajtëse nëpërmjet puntelimit apo pajantimit të strukturave horizontale dhe çatisë që shkarkon ngarkesa në to.

5.3 Restaurimi i harqeve, qemerëve dhe kupolave:

a) Si elemente konstruktive të pasurive kulturore arkitektonike, harqet, qemerët dhe kupolat janë vazhdimisht objekte të ndërhyrjeve restauruese.

b) Dëmtimet e harqeve, qemerëve dhe kupolave mund të shkaktohen si pasojë e degradimit, kalbjes apo zhdukjes me kalimin e kohës të sistemit të tirantave dhe brezave që kanë qenë pjesë e ndërtimit për të thithur shtytjet e mbulesave të harkuara.

c) Rivendosja e sistemit të ekuilibrit të ngarkesave nëpërmjet rivendosjes së tirantave prej druri apo metalikë dhe mbërthimi i tyre në muraturë duhet të paraprijë procesin e restaurimit të harqeve dhe qemerëve. Në rastin e pranisë së pikturës murale në sipërfaqen e muraturës, vendosja e sistemit të tirantave duhet të realizohet me kujdes për të mos cenuar apo dëmtuar pikturën murale.

5.4 Restaurimi i çatave:

a) Restaurimi i strukturës së çatave/mbulesës përbën një nga ndërhyrjet më të shpeshta që u nënshtrohen pasuritë kulturore gjatë gjithë ekzistencës së tyre. Çatitë më së shumti dëmtohen nga hyrja e ujit nën mbulesën me tjegulla/rrasa guri.

b) Ndërhyrjet në këto struktura duhet t'i japë rëndësi përforcimit të elementeve të vjetra, të lehtësojë ngarkesën e tyre, nëse janë dobësuar, të ruajë sa më shumë nga elementet apo struktura e vjetër e çatisë.

c) Masa më e mirë për të zgjatur jetën e çatave është sigurimi i papërshkueshmërisë së ujit të shirave e dëborës në brendësi të strukturës së tyre.

5.5 Restaurimi i dysHEMEVE dhe i tavaneve/strukturave horizontale:

a) Restaurimi i dysHEMEVE të shtruar me pllaka duhet bërë duke ruajtur materialin e vjetër dhe duke e ngjitur atë të dëmtuar. Zëvendësimi tërësor i një dysHEMEJE të vjetër, për arsye të konsumimit të saj konsiderohet i dëmshëm, pasi ajo përbën dokument me vlerë shkencore dhe historike.

b) Restaurimi i dysHEMEVE me dërrasa mbi trarë druri duhet të konsistojë në mirëmbajtjen e vazhdueshme, përforcimin dhe plotësimin e atyre elementeve, që nuk mund të mbahen dot, si dhe ribërjen e shtresës. Ribërja duhet të realizohet me të njëjtën teknikë si e vjetra kur ajo konsiderohet me vlera, ose sipas teknikave të kohës duke ruajtur



gjurmë të vjetra pa dëmtuar vlerat estetike të mjedisit.

c) Restaurimi i tavaneve duhet t'u përmbahet të njëjtave norma teknike, si dhe restaurimi i dyshemeve. Kur tavani është i rindërtuar dhe nuk paraqet vlera ai mund të ribëhet sipas teknikave të kohës. Tavanet e vjetra duhet të ruhen si vepra arti të paimitueshme. Duke qenë praktikë e ndjekur më parë mund të adaptohen trarë të marra nga ndërtesa të tjera në një dhomë të një pasurie kulturore që restaurohet me kusht që zgjedhja të mos jetë në disharmoni me vlerat estetike të dhomës.

6. Dëmtimet nga lagështia dhe masat kundër saj:

a) Lagështia në brendësi të strukturave është një nga shkaqet kryesore të dëmtimit të materialeve të përdorura. Problemi paraqitet me shumë rëndësi në rast të pranisë së pikturave murale në sipërfaqe të muraturave. Për të përcaktuar nivelin dhe natyrën e lagështisë është e nevojshme matja sistematike e një sërë të dhënash dhe interpretimi i tyre, si më poshtë:

i. matja e temperaturës dhe lagështisë së ajrit në brendësi të ndërtesës dhe mjedisin rrethues të paktën gjatë një viti;

ii. matja e lagështisë sipërfaqësore të mureve

iii. matja e përqendrimit dhe shpërndarjes së lagështisë në mur që lejon përcaktimin nëse lagështia vjen nga toka/kapilaritet, çatia apo nga muret/kondensim. Për këtë merren kampione dhe peshohen para dhe pas tharjes.

iv. matja e temperaturës së mureve dhe qemerëve.

b) Për mënjanimin e lagështisë që hyn në brendësi të monumentit dhe strukturave të tij, është e mjaftueshme riparimi i të metave të çatisë dhe kanalizimeve dhe i fugave sipas rastit. Në riparimin e fugave duhet të përdoret llaç që lejon frymëmarrjen e muraturës. Në rastin e lagështisë, si pasojë e kapilaritetit, mjeti i vetëm mbetet izolimi sa më i mirë i mureve në pjesën e poshtme që janë në kontakt me dheun. Në rastin e ujërave sipërfaqësore, ndërhyrja më e domosdoshme është drenazhimi i tyre dhe largimi nga terreni pranë pasurisë kulturore.

c) Metoda e izolimit të sipërfaqes së themlit në kontakt me terrenin jep rezultat vetëm në rastin e ujërave sipërfaqësore. Në rastin e ujërave nëntokësore kjo ndërhyrje është e dëmshme, pasi nuk lejon avullimin sipërfaqësor, duke shtuar

ngritjen kapilare në lartësi. Në rastin e ujërave nëntokësore mund të përdoren muret izoluese të jashtëm të cilat ndihmojnë në largimin e ujërave nëntokësore dhe lejojnë avullimin nën nivelin e tokës. Përdorimi i materialeve veshëse të papërshkueshme nga uji si për muret dhe për dyshemetë rëndon gjendjen e dëmtimeve nga lagështia për kapilaritet e cila do të ngjitet më lart.

ç) Për sa i përket lagështisë së kondensimit duhet studiuar mirë shkaku i saj. Në rast se shkaktohet nga një izolim jo i mirë i dyshemesë mund të zgjidhet me izolimin e saj. Në rast se lagështia vjen nga muret mund të mënjanohet duke rritur temperaturën e brendshme të ambientit.

7. Restaurimi i zbukurimores në një monument arkitekture:

a) Pasuritë kulturore të arkitekturës në shumë raste ruajnë vlera të zbukurimores, si: piktura murale, mozaikë, relieve skulpturore, gdhendje në dru, stuk relieve, të cilat janë pjesë përbërëse e trajtimit arkitektural të brendësisë dhe pamjes së jashtme të tyre. Mjaft elemente të zbukuruara janë pjesë përbërëse e elementeve të ndërtesës, si tavane, mafie, oxhaqe, musandra, ikonostase, korniza, frontone. Të gjitha këto përbëjnë vlera artistike që duhet të ruhen, të konservohen dhe të restaurohen si pjesë përbërëse e monumentit e vlerave të tij dokumentare dhe estetike.

b) Për këtë shkak restaruratori i arkitekturës është në mënyrë të pashmangshme pjesë e grupit të restaurimit të këtyre veprave krahas restauratorit të veprave të artit. Por në mjaft raste gjendja e veprave të artit apo dhe gjendja e vetë pasurisë kulturore rrezikon humbjen e vlerave të tyre. Në këto raste ato mund të lëvizin për të shpëtuar nga degradimi i mëtejshëm që mund të çojë në humbjen e tyre.

c) Në restaurimin e veprave të artit në stuko relief si tavane, oxhaqe së pari bëhet pastrimi nga mbivënit e shumta me sherbet gëlqere. Ky pastrim bëhet me kujdes dhe në mënyrë mekanike. Plotësimet e elementeve të zbukuruara në stuko relief duhet të shmangen për të mos falsifikuar veprën e artit. Në raste të veçanta kur kemi të bëjmë me pjesë të vogla ato duhet të mos punohen imtësisht dhe të jenë të dallueshme.

ç) Masat restauruese duhet të vlerësojnë veprën e artit në veçanti dhe të arkitekturës së pasurisë kulturore në tërësi. Gjithë ndërhyrjet duhet të



tentojnë në pastrimin, përforcimin dhe vlerësimin e tyre.

8. Restaurimi i portave, dyerve, dritareve, elementeve të tyre përbërëse dhe ndihmës, si dhe fashaturave në fasadë:

a) Dritaret janë një përbërës thelbësor i ndërtesave, për veçoritë e funksionale në ofrimin e dritës, ajrosjes dhe pamjes, si dhe element arkitektonik. Duke siguruar shkallën, profilin dhe përbërjen e një fasade, dritaret janë shpesh një nga tiparet më të rëndësishme që përcaktojnë karakterin e një strukture. Portat, dyert, dritaret dhe elementet e tyre përbërëse dhe ndihmëse duhet të konsiderohen domethënëse për një ndërtesë, nëse:

- i. janë origjinale;
- ii. pasqyrojnë qëllimin origjinal të projektimit të ndërtesës;
- iii. pasqyrojnë stilin e një periudhe ose një teknikë të veçantë ndërtimore;
- iv. janë shembuj të jashtëzakonshëm mjeshtërie ose dizajni.

b) Restaurimi i portave, dritareve dhe fashaturave në fasadë duhet të konsistojë në mirëmbajtjen e vazhdueshme, e cila ka të bëjë me trajtimin e tyre për mbrojtjen ndaj agjentëve atmosferikë, biologjikë, insekteve dhe efektit kohë.

c) Në trajtimin e portave, dyerve, dritareve, pjesëve të tyre përbërëse dhe ndihmëse, si dhe fashaturave të dëmtuara duhet t'i jepet rëndësi konservimit, përforcimit dhe restaurimit të tyre, duke konsideruar zëvendësimin apo ribërjen si zgjidhje të fundit, kur nuk gjykohet i mundshëm realizimi i asnjë prej metodave më sipër.

ç) Rindërtimi i këtyre elementeve duhet të realizohet me të njëjtën teknikë si e vjetra, kur ajo konsiderohet me vlera ose sipas teknikave të kohës, duke ruajtur gjurmë të vjetra pa dëmtuar vlerat estetike.

d) Kur portat, dritaret dhe fashaturat në fasadë janë të rindërtuara dhe nuk paraqesin vlera, mund të ribëhen sipas teknikave tradicionale të zonës për këto elemente.

C. Norma teknike të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore vepra arti

C.1 Restaurimi i veprave të artit si piktura murale, piktura në dru.

1. Në rastet ku nuk dallohen mbivendosjet e shtresave me sy të lirë, duhet kryer radiografia me rrezet përkatëse që nuk dëmtojnë pikturën.

2. Në rastin e pikturave të lëvizshme jomurale duhet fotografuar edhe pjesa e prapme e mbajtëses së pikturës. Nëse nga dokumentimi fotografik do të rezultojnë elemente problematike, ato duhet të referohen dhe të përfshihen në ditar dhe me të gjithë problematikën e tyre.

3. Pas fotografimit të pikturave duhet operuar me të gjitha shtresat, edhe ato më të imëtat, deri në suport, për të parë dhe realizuar sesione stratigrafike, nëse ekzistojnë shtresëzime ose jo. Këto sesione merren nga pjesë periferike të pikturës. Pikat e këtyre sondazheve duhen shënuar edhe në fotografitë e kryera në dritën natyrale dhe referohen në ditar/kartelë.

4. Për sa u përket pikturave murale ose mbi gur, terakotë ose mbështetëse tjetër të palëvizshme, duhet të kryhen kontrollet, si vijon:

a) sigurohen kushtet fizike të suportit, në raport me lagështirën;

b) përcaktohet nëse ka lagështirë të infiltruar, të kondensuar apo kapilare, duke marrë kampione të llaçit dhe të përbërjes së murit, të cilat analizohen duke matur kështu shkallën e lagështirës;

c) analiza mikrobiologjike, nëse dyshohet ose duken formacione biologjike.

5. Restaurimi duhet të paraprihet nga:

a) kryerja e sondazheve të cilët orientojnë kryerjen e ndërhyrjes së restaurimit në mënyrën e duhur, si në rastin kur bëhet fjalë për pastrime të thjeshta, për fiksime, për lëvizje të shtresave të ripikturimeve, zhvendosje të tyre ashtu dhe për rikompozim të fragmenteve;

b) përcaktimi i teknikës që do të përdoret;

c) përzgjedhja me kujdes e materialeve që do të përdoren për restaurimin e saj.

6. Integrimi në pikturë duhet të jetë interpretim kritik i mungesës së imazhit dhe nuk duhet kryer atje ku imazhi mungon. Në çdo rast, materialet e përdorura duhet të jenë reversibël dhe të dallueshme nga ato origjinale.

7. Për sa u përket pastrimeve, mund të bëhet kryesisht në dy mënyra:

a) me mjete mekanike, bisturitë të cilat duhen përdorur gjithnjë nën kontrollin e pinakoskop-it;

b) me mënyra fiziko-kimike, solucionet dhe shkrirësit, të një natyre të tillë që të kenë pikën e duhur të avullimit, me qëllim që të mos depërtojnë në shtresat e pikturës dhe që më pas të neutralizohen menjëherë me solucione përkatëse, duke evituar fiksimin në shtresat e pikturës. Përpara



se këto lëndë të përdoren duhen eksperimentuar, për t'u siguruar që nuk dëmtojnë cipën/patinën origjinale të pikturës.

8. Përfshihet çdo lloj mjeti që zhduk vizibilitetin/pamjen ose mundësinë e ndërhyrjes dhe kontrollin direkt mbi pikturë. Përpara se të vazhdohet me pastrimin, me çfarëdolloj mjeti të lejuar që ai do të kryhet, duhet kontrolluar me hollësi pozicioni statik i pikturës, në çfarëdo suporti që të jetë vendosur, duke vazhduar më tej me fiksimin e pjesëve të shqitura ose të rrezikuara.

9. Sido që të kryhet ky fiks, lokalisht ose nëpërmjet një solucioni të shpërndarë në mënyrë uniforme, penetrimi i tij arrihet përmes një vatre nxehtësie konstante dhe jo të rrezikshme për konservimin e pikturës. Është rregull që të hiqet çdo gjurmë që mbetet nga lënda fiksuese mbi sipërfaqen e pikturuar. Për këtë qëllim, në rastin e pastrimit me mjete mekanike, pas fiksimit duhet kontrolluar ndërhyrja në pinakoskop.

10. Për sa i përket trajtimit me shtresë solucioni të të gjithë pikturës është e detyrueshme që kjo të përdoret pas ringjithjes të pjesëve të ngritura dhe/ose të rrezikuara. Lënda e përdorur duhet të jetë një ngjitës i holluar dhe i ndryshëm nga ai i përdorur gjatë procesit të fiksimit.

11. Nëse suporti i pikturës është i drunjtë, i ngjitur, me krimba, termite, piktura duhet t'u nënshtrohet operacioneve të dezinfektimit me gazra specifike, për të vrarë insektet, pa dëmtuar pikturën. Duhet evituar trajtimet me substanca të lëngëta.

12. Nëse gjendja e grundit ose, të dyja së bashku, për pikturat e luajtshme jomurale, është e dëmtuar, duhet që grundi i pikturës të shkëputet i gjithi me bisturi. Aty ku është e mundur, grundi duhet konservuar, ashtu siç është, për të ruajtur origjinalitetin e pikturës. Në rastet kur grundi mungon, ai duhet zëvendësuar për arsye strukturale dhe estetike.

13. Kur, për shkak të dëmtimeve të pariparueshme, është i domosdoshëm zëvendësimi i suportit të drurit, përdoret një suport tjetër prej materiali drusor rezistent me parametra shumë të mirë stazhionimi, stabiliteti që t'i rezistojë ndryshimeve në kohë.

14. Në rast se suporti origjinal prej druri është në gjendje të mirë, por ka nevojë për drejtim, përforsime ose parketim, gjë e cila ndikon vetëm

estetikisht, ndërhyrja duhet të plotësojë kriteret, si vijon:

a) të mos ndërhyhet në një dru të vjetër dhe tashmë të stabilizuar;

b) të respektojë rregulla precize teknologjike, të merret nga druri një seksion, të hetohet botanika e tij dhe të analizohet % e lagështirës në dru.

15. Çdo lloj shtese duhet të bëhet me dru të stazhionuar dhe me segmente të vogla me qëllim që të përshtatet sa më mirë me suportin e vjetër, tek i cili montohet. Parketimi, bëhet me material druri, i njëjtë me origjinalin dhe i stazhionuar me parametrat e duhur të lagështirës për të siguruar lëvizjet natyrale të drurit mbi të cilin fiksohet.

16. Për pikturat me kornizë origjinale, korniza nuk hiqet, përveç rasteve kur ajo nuk mund ta kryejë më funksionin e saj, për shkak të dëmtimeve të rënda që mund të ketë pësuar. Në rastin kur korniza mungon apo duhet zëvendësuar, duhet respektuar periudha në të cilën është realizuar vepra dhe e gjithë krijimtaria e autorit që ka realizuar veprën

17. Operacioni i restaurimit në pëlhurën e pikturës, duhet të evitohet ngjeshjet e tepërta dhe temperaturat shumë të larta për pelikulën e pikturuar. Gjatë heqjes së pikturës nga mbajtësja e vjetër prej druri apo kanavace duhet të ruhen nënshtresat dhe format origjinale të sipërfaqes së pikturuar. Nëse bordurat e pëlhurës janë të konsumuara, ato mund të përforcohen me shirita prej pëlhure, në mënyrë të tillë që të mos kapërcejnë bordin e telajos nën pelikulën e pikturës.

18. Duhet të evitohen gjithnjë, në mënyrën më taksative operacionet e aplikimit "transportimit" të një pikturë nga telajo mbi një suport të ashpër. Telajot duhet të jenë të konceptuara në mënyrë të tillë që të sigurojnë jo vetëm tensionin e duhur, por edhe të stabilizojnë automatikisht pikturën në raste të ndryshme termoigrometrike.

19. Pikturat murale janë pjesë përbërëse e arkitekturës. Heqja apo zhvendosja e tyre duhet të jetë e justifikuar dhe duhet kryer vetëm në se ndërtesa apo suporti ku piktura është vendosur rrezikohet të shkatërrohet.

20. Në rastin e temperave dhe përgjithësisht për pjesët në tempera të afreskeve ku disa ngjyra nuk mund të rifreskohen, duhen kryer fiksime parandaluese. Kur ngjyrat e pikturës murale i nënshtrohen një gjendjeje pak a shumë të avancuar të pluhurizimit, duhet një kujdes i veçantë për



pastrimin, në mënyrë që të parandalohet zhvendosja e pluhurit të ngjyrës origjinale.

21. Për fiksimin e ngjyrës duhet të përdorim fiksues me natyrë joorganike, duke forcuar sa më pak të jetë e mundur tonet origjinale. Pluhuri duhet ekzaminuar për të parë nëse përmban formacione të dëmshme dhe cilat janë arsyet nëse kjo vërtetohet. Nëse gjendet shkaku i formimit të këtyre formacioneve dhe solucioni i duhur për luftimin e tyre, duhet të sigurohemi se këto solucione nuk dëmtojnë pikturën dhe mund të pastrohen kollaj.

22. Mbështetësi/suporti mbi të cilën do të rivendoset piktura, duhet të ofrojë garanci stabiliteti, inerci dhe neutralitet. Duhet, gjithashtu, që suporti të ndërtohet në dimensionet e pikturës, pa qepje të ndërmjetme që mund të dëlnin papritur me kalimin e kohës mbi sipërfaqen e pikturës. Ngjitësi me të cilin do të fiksohet piktura mbi mbështetësen e re, duhet të jetë i tillë që të shkrihet me lehtësi me një lëndë që nuk e dëmton pikturën.

23. Në rastin e rreziqeve që vijnë nga ndryshimet klimatike në pikturat murale të interierëve, në shpellat prehistorike, varret, ambiente të vogla është e nevojshme të mbahen konstantë dy faktorë thelbësorë për një konservim sa më të mirë të pikturave, shkalla e lagështisë dhe temperatura e tij. Këto faktorë ndryshojnë lehtë nga shkaqe dhe faktorë të jashtëm ambientale, sidomos nga hyrje-daljet e vizitorëve, nga ndriçimi i tepërt, nga ndryshime të forta atmosferike. Prandaj, është e nevojshme të menaxhohet me kujdes prania e vizitorëve, të krijohen tamponë të klimatizuar mes ambientit antik që mbrohet dhe ambientit të jashtëm.

24. Mozaikët duhet të përforcohen në pjesët e tyre të dëmtuara që nga momenti i parë i daljes së tyre në dritë nga gërmimi i monumentit. Më tej duhen marrë masa mbrojtëse duke i mbuluar me shtresë rëre.

25. Mozaikët duhet të ruhen në vendin e tyre në monument *in situ*. Në rastet kur paraqitet e domosdoshme heqja e tyre, kjo duhet të bëhet duke mos prurë ndryshimin e sipërfaqeve të deformuara përveç dëmtimeve të vogla. Çdo drejtim i saj do të shkaktonte dëmtime të figurave të mozaikut pra do të tjetërsojë vlerat dhe nivelin origjinal të mjeshtërive të veprave të artit. Përpara se të aplikohet rrjeta e armaturës së re mbështetëse, duhet të sigurohemi për gjendjen fizike të kubikëve

të mozaikut dhe të kryejmë ndonjë konsolidim të mundshëm. Shkëputja e tij, pa operuar me çarje, me metodat moderne mund të kryhet edhe për sipërfaqe të mëdha. Gjithashtu, sistemi i vendosjes në suport metalik të paoksidueshme rezulton më efikas dhe rezistenti ndaj agentëve atmosferikë. Për mozaikët e destinuar për ekspozim në muze përdoret gjerësisht suporti i tipit “sanduiç” me materiale të lehta, rezistente dhe lehtësisht të menaxhueshme.

26. Ndërhyrje mbrojtëse janë dhe mbulesat me materiale të lehta që lejojnë ndriçimin, por ndalojnë rrezet e dëmshme, struktura metalike, që mbrojnë godinat ku janë ekspozuar mozaikët. Në këto raste, skeleti i strukturave mbështetet jashtë mureve rrethuese duke lënë të paprekur dyshtemenë. Mbulesat duhet të përshtaten me mjedisin rrethues natyral apo monumental arkeologjik dhe të mos dëmtojnë vlerat e rrënojave që mbrojnë.

C.2 Restaurimi i veprave të artit skulpturë, dru i gdhendur, gur i gdhendur, metal, allçi

1. Problemi më i veçantë i skulpturave është përcaktimi i gjendjes të konservimit të lëndës me të cilën janë krijuar. Kjo arrihet nëpërmjet kryerjes së radiografive, gamagrafivë, ultratingujve, valëve magnetike.

2. Për restaurimin e skulpturave fillimisht përcaktohet lënda dhe më tej teknika që është ndjekur në krijimin e skulpturave mermer, gur, stuko, brumë letre, terrakotë, baltë e pjekur, baltë jo e pjekur por e pikturuar, allçi si kopje e parë. Kur nuk rezultojnë pjesë të pikturuara dhe është i nevojshëm pastrimi, përjashtohet kryerja e lavazheve të tilla të cilat, edhe pse nuk cenojnë lëndën, mund të dëmtojnë cipën/patinën.

3. Në rastet e skulpturave të nxjerra gjatë gërmimeve ose të gjetura në ujëra dete e lumenj, nëse mbi këto është formuar cipë gëlqerore, kjo duhet të pastrohet me mjete mekanike, ose me solucione të tilla që nuk cenojnë materialin e skulpturës dhe që nuk fiksohen.

4. Skulpturat prej guri të vendosura në ambiente të jashtme të ndërtesave ose në sheshe duhen vrojtuar vazhdimisht për të ndërhyrë në kohën e duhur, duke marrë masa mbrojtëse qoftë edhe sezonale. Kur të gjitha këto masa nuk japin rezultat, skulpturat duhen transferuar në ambiente të mbyllura. Ndërsa për konservimin sa më të mirë të shatërvanëve prej guri ose bronzi, duhet bërë dekalcifikimi i ujërave, duke eliminuar kështu



kripëzimin e pjesëve dhe pastrimet e shpeshta që mund ta dëmtojnë veprën.

5. Për skulpturat në dru dhe që janë në gjendje rreziku, përdorimi i lëndëve fiksuese duhet të jetë në varësi të ruajtjes së pamjes origjinale të lëndës drusore. Nëse druri është infektuar nga miza, insekte, duhet t'i nënshtrohet trajtimit me gazra të përshtatshëm. Ndërhyrja me qëllim drejtimin, lidhjen apo/dhe integrimin e tyre bëhet nëpërmjet rregullave teknologjike të përcaktuara saktë që respektojnë vijueshmërinë e fibrave të drurit duke përdorur në çdo rast të njëjtin lloj botanik.

6. Në këto objekte, edhe pse mund të mungojnë pjesët e pikturuara, duhet evituar trajtimi me solucione që, mund të shndërrojë pamjen e drurit. Në rastin e skulpturave të fragmentuara, përdorimi i bashkuesve ose mbështetësve duhet të jetë në varësi të zgjedhjes së një metalit të paoksidueshëm.

7. Për skulpturat në allçi, si kopje të para origjinale, lëvizja nga vendi ku ruhen, lejohet vetëm në rastin kur ka një kopje të dytë.

8. Për objektet në bronz rekomandohet një kujdes i veçantë për ruajtjen e patinës, nëse tek to nuk vërehen gërryerje të shkallës së lartë.

9. Një vepër e restauruar nuk rivendoset në vendin e saj origjinal, nëse restaurimi është kryer i kushtëzuar nga kushtet termoigrometrike:

a) të vendit në përgjithësi; ose

b) të një pjese në veçanti, në rast se vendi ose pjesa e vendit nuk kanë pësuar ndërhyrje të tilla, përmirësime, klimatizime, që garantojnë konservimin dhe mbrojtjen e veprës së artit në të ardhmen.

Ç. Norma teknike për mbrojtjen, konservimin dhe rehabilitimin e “qendrave historike, të zonës mbrojtëse, asambleve historiko-urbane dhe peizazhe kulturore”

1. Qendrat historike të qyteteve apo të fshatrave, Ansamblet Historiko-Urbane, në kontekstin e tyre territorial, paraqesin një pjesë thelbësore të trashëgimisë sonë kombëtare dhe universale, dhe duhet të shihen në grupin e strukturave, hapësirave dhe veprimtarive njerëzore, normalisht në një proces evolucioni dhe ndryshimi të vazhdueshëm. Kjo përfshin të gjithë sektorët e popullatës dhe kërkon një proces planifikimi të integruar brenda të cilit vendoset një larmi e madhe e ndërhyrjeve.

2. Konservimi në kontekstin urban ka të bëjë me grupe ndërtesash dhe hapësirash të zbuluara që

përbëjnë pjesë të zonave urbane me përhapje më të madhe ose të bërthamave më të vogla të vendosura në një kontekst urban ose rural, duke përfshirë dhe vlerat jomateriale. Në këtë kontekst, ndërhyrja konsiston në referimin gjithnjë të ansamblit në tërësinë e tij morfologjike, funksionale dhe strukturore, si pjesë e territorit të tij, kontekstit të tij dhe peizazhit përreth.

3. Ndërtesat në zonat historike mund të mos kenë një vlerë të lartë arkitektonike në vetvete, por duhet të ruhen për unitetin e tyre organik, për lidhjet e tyre dimensionale, konstruktive, hapësinore, dekorative dhe kromatike që i karakterizojnë ato si pjesë pjesë integrale e kontekstit urban apo rural.

4. Projekti i restaurimit të “Qendrave historike” të qyteteve apo fshatrave, dhe ansambleve urbane duhet të përfshijë menaxhimin e transformimeve dhe një verifikim të qëndrueshmërisë së zgjedhjeve, duke marrë parasysh aspektet mbrojtëse së bashku me aspektet sociale dhe ekonomike. Projekti i restaurimit të zonave historike supozon ndërtesat në funksionin e tyre të dyfishtë:

a) të elementeve që përcaktojnë hapësirat e qytetit në tërësi;

b) të sistemeve të shpërndarjes së hapësirave të brendshme të lidhura rreptësisht me vetë ndërtesën.

5. Peizazhi i kuptuar si trashëgimi kulturore rezulton nga ndërveprimi i zgjatur në shoqëritë e ndryshme midis njeriut, natyrës dhe mjedisit fizik. Dëshmon për marrëdhëniet evolucionare të shoqërisë dhe individëve me mjedisin e tyre. Ruajtja, mbrojtja dhe zhvillimi i saj u referohet karakteristikave njerëzore dhe natyrore, duke integruar vlerat materiale dhe jomateriale. Është e rëndësishme të kuptohen dhe të respektohen karakteristikat e peizazhit dhe të zbatohen ligje dhe standarde të përshtatshme për të harmonizuar funksionet territoriale në lidhje me vlerat thelbësore të tij. Në shumë shoqëri, peizazhi është i lidhur historikisht me territoret urbane.

6. Integrimi midis ruajtjes së peizazhit kulturor, zhvillimit të qëndrueshëm në rajone dhe lokalitete të karakterizuara nga aktivitete bujqësore dhe karakteristikat natyrore kërkon një mirëkuptim dhe ndërgjegjësim të marrëdhënieve me kalimin e kohës. Kjo kërkon krijimin e lidhjeve me mjedisin e ndërtuar të metropoleve dhe qyteteve. Ruajtja e



integruar e peizazhit kulturor përfshin vlera sociale, kulturore dhe estetike.

7. Roli i teknikave në fushën e ruajtjes dhe restaurimit është i lidhur ngushtë me kërkimin shkencor ndërdisiplinor mbi materiale specifike dhe teknologji specifike të përdorura në ndërtimin, riparimin dhe restaurimin e trashëgimisë së ndërtuar. Ndërhyrja e zgjedhur duhet të respektojë funksionin origjinal dhe të sigurojë përputhshmërinë me materialet, strukturat dhe vlerat arkitektonike ekzistuese.

8. Materialet dhe teknologjitë e reja duhet të testohen në mënyrë rigoroze, të krahasohen dhe të përshtaten me nevojat reale të ruajtjes. Kur aplikimi në vend i teknikave të reja merr një rëndësi të veçantë për ruajtjen e karakteri origjinal, është e nevojshme të monitorohen vazhdimisht rezultatet e marra, duke marrë parasysh sjelljen e tyre me kalimin e kohës dhe mundësinë kthyeshmërisë/reversibël).

9. Njohuria për materialet dhe teknikat tradicionale dhe ruajtja e tyre në kontekstin e shoqërisë moderne duhet të stimulohet, duke qenë në vetvete një komponent i rëndësishëm i trashëgimisë.

10. Ndërhyrjet e restaurimit në qendrat historike kanë si qëllim garantimin nëpërmjet mjeteve dhe instrumenteve të zakonshme dhe të veçanta të vazhdimësisë në kohë të vlerave që karakterizojnë këto komplekse.

11. Restaurimi nuk kufizohet vetëm në operacione për konservimin e karakterit formal të arkitekturave ose ambienteve të veçanta, por shpërndahet në konservimin në esencë të karakteristikave të përbashkëta të gjithë ansamblit urbanistik dhe të të gjitha elementeve që përcaktojnë këto karakteristika.

12. Që ansamblet urbanistike të mund të mbrohen, të zhvillohen dhe të mbijetojnë në kohë e në vazhdimësi në jetën civile dhe moderne, duhet të jenë të organizuara në kontekstin e tyre më të gjerë urban dhe territorial, në raport me zhvillimet e ardhshme duke koordinuar zhvillimet urbanistike në mënyrë që të sigurohet mbrojtja dhe rikuperimi i qendrës historike duke nisur fillimisht nga pjesa periferike e qytetit, përmes një programimi të përshtatshëm të ndërhyrjeve në territor.

13. Ansambli i ri urban duhet të konfigurohet në mënyrë të tillë që qendrave historike t'i hiqen ato funksione, të cilat pengojnë dhe nuk përshtaten

me rikuperimin dhe mirëmbajtjen e këtyre qendrave, në kuptim të konservimit sa më të mirë të tyre. Ky konfigurim dhe koordinim duhet parë edhe në raport me nevojën për mbrojtjen e kontekstit të përgjithshëm territorial mjedisor, mbi të gjitha kur ky i fundit ka vlera domethënëse e të veçanta, të cilat lidhen me strukturat historike të transmetuara deri në ditët e sotme.

14. Elementet e veçanta që merren në konsideratë për mbrojtjen e ansamblit në të gjithë bashkësinë e tij janë:

- a) elemente të shumta të ndërtimit;
- b) elementet që mbushin hapësirat e jashtme, rrugë, sheshe;
- c) elementet që mbushin hapësirat e brendshme, kopshte, parqe, hapësira të lira;
- ç) struktura të tjera domethënëse, mure, porta;
- d) elemente të tjera natyrore që shoqërojnë gjithë këtë bashkësi si konture natyrore, rrjedhje ujore, veçanësi gjeomorfologjike.

15. Elementet e mësipërme të ndërtimit duhen konservuar jo vetëm në aspektin e tyre formal që karakterizon shprehjen arkitektonike apo ambientale të tyre, por edhe në karakterin e tyre tipologjik, për të shprehur funksionet që me kalimin e kohës tregojnë përdorimin e vetë këtyre elementeve, dhe përshtatshmërisë për personat me aftësi të kufizuara.

16. Çdo ndërhyrjeje restaurimi në vlerat urbanistike, arkitektonike, ambientale, tipologjike, ndërtuese paraprihet nga një një operacion i kujdesshëm i leximit historiko-kritik.

17. Në të gjithë kompleksin, përcaktuar si qendër historike, duhet operuar sipas kritereve homogjene, për individualizimin e niveleve të ndryshme të ndërhyrjes në nivel urbanistik dhe nivel ndërtimi, duke e kualifikuar ndërhyrjen si “përmirësim konservues” të nevojshëm.

18. Me “përmirësim konservues” do të kuptohet para së gjithash mirëmbajtja e strukturave ndërtimore në përgjithësi, si dhe ruajtja e karakteristikave të përgjithshme ambientale, që sjell ruajtjen integrale të ansambleve monumentale dhe ambientale më domethënëse dhe përshtatjen e elementeve të tjera ose organizmave, veprave të veçanta të ndërtimit me nevojat e jetës moderne, duke konsideruar të jashtëzakonshme zëvendësimet, qoftë edhe të pjesshme, të vetë elementeve dhe vetëm atëherë kur elementet



përshtaten dhe adaptohen me karakterin e përgjithshëm të qendrës historike.

19. Ndërhyrjet kryesore në nivel urbanistik janë:

a) ristrukturimi urbanistik, i cili ka për qëllim lirim e qendrave historike nga ato destinacione funksionale, teknologjike dhe nga të gjitha funksionet e tjera, që provokojnë një efekt kaotik dhe degradues tek to. Ristrukturimi urbanistik verifikohet dhe më pas të korrigjohet aty ku nuk ka logjikë, në raport me strukturën territoriale ose urbane me të cilën ai formon njësinë si të tërë, ristrukturimi përfshin kryerjen e:

i. analizës së rolit territorial dhe funksional që qendra historike ka kryer në të shkuarën dhe në të tashmen;

ii. analizës dhe ristrukturimit në raportet ekzistuese mes qendrës historike dhe zhvillimeve urbanistike e ndërtimeve bashkëkohore, mbi të gjitha nga këndvështrimi funksional sidomos në përputhje me funksionet administrativo-sociale.

b) riorganizimi në vazhdimësi, i cili përfshin analizën dhe rishikimin e vazhdueshëm të lidhjeve të ndryshme dhe fluksit të trafikut që përfshijnë strukturën, me qëllim reduktimin e patologjive, të tilla dhe ridrejtimin e përdorimit të qendrave historike në përputhje me funksionet e dikurshme. Duhet konsideruar këtu mundësia e futjes dhe përdorimit të pajisjeve dhe shërbimeve publike të lidhura ngushtë me nevojën të domosdoshme të jetës së përditshme të qendrës historike;

c) rishikim i harmonizimit urban, i cili përfshin rrugët, sheshet dhe të gjitha hapësirat e lira të jashtme kopshte, hapësira të lira, parqe, me qëllim krijimin e një lidhjeje homogjene mes ndërtesave dhe hapësirave të jashtme.

20. Tipat kryesorë të ndërhyrjeve në nivel ndërtues janë:

a) përmirësimi statik dhe pamor i ndërtesave, duke ruajtur strukturën dhe përdorimin e ekuilibruar të tyre. Kjo ndërhyrje kryhet sipas teknikave, modaliteteve dhe udhëzimeve që kryhen edhe restaurimet arkitektonike. Në këtë lloj restaurimi ka rëndësi të madhe respektimi i cilësive tipologjike, konstruktive dhe funksionale të ansamblit/veprës, duke evituar ato transformime që tjetërsojnë karakteret;

b) rinovimi i brendshëm funksional i ndërtesave. Edhe në këtë tip ndërhyrjeje ka rëndësi respektimi i ekuilibrit dhe cilësisë tipologjike dhe

konstruktive të ndërtesave, duke ndaluar ato ndërhyrje që tjetërsojnë dhe deformojnë karakteret;

c) instrumentet operuese, si:

i. plane të përgjithshme rregulluese, që rregullojnë raportet mes qendrës historiko-territoriale dhe qendrës historike e qytetit si një të tërë;

ii. plane të hollësishme që lidhen me ristrukturimin e qendrës historike në elementet e saj më domethënëse;

iii. plane ekzekutive të veçanta, të shtrirë në zona të izoluara ose në një bashkësi elementesh të grupuar në mënyrë organike.

21. Bashkëpunimi i ngushtë i institucioneve të specializuara sipas ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, për të gjitha rastet, kur “pasuritë kulturore”, në kuptim të ligjit nr. 27/2018, ndërthuren me “zonat”, sipas përkufizimeve të ligjit nr. 81/2017”.

D. Norma teknike për konservimin dhe restaurimin e librit

1. Rregulli kryesor në restaurimin e librit është të evitohen të gjitha operacionet që mund të tjetërsojnë pamjen dhe vlerën e përgjithshme të veprës/librit. Për këtë arsye, duhet të kryhet konservimi i çdo elementi të veçantë.

2. Libri është një objekt që preket, hapet, manipulohet, duhet të jetë funksional në përdorimin e tij. Kështu që në disa raste lidhja origjinale mund të mos imitohet, për shkak të mosprakticitetit në përdorim të librit.

3. Përpara se të fillohet me operacione të restaurimit në këtë fushë, duhet:

a) të merret në konsideratë vepra në kompleksitetin dhe larminë e saj historike, artistike, materiale dhe funksionale;

b) të kryen kërkime dhe studime të përshtatshme për llojin dhe përbërjen e letrës së përdorur.

4. Kur librat janë objekte të trashëgimisë kulturore, duhet marrë në konsideratë përbërja e tyre materiale si letër, pergamenë, papirus ose ndonjë material tjetër mbi të cilin shkruhet, si: dru, metal, karton, lëkurë, spango, pëlhurë.

5. Njohja e origjinës së çdo materiali është e domosdoshme për të proceduar me korrektësi operacionin e restaurimit, ashtu siç është i domosdoshëm edhe studimi i materialeve “të reja” që do të përdoren në librat që do të restaurohen.



6. Ndërhyrjet duhet të kushtëzohen nga hetimet që kryhen nga ekspertët duke filluar që nga bibliotekari, historia e librit, e dekoracionit, rëndësia e veprës, te biologu, teknologu, fizikani dhe restauratori.

7. Në biblioteka duhen kryer studime mbi gjendjen e konservimit të fondeve të librave, duke i rëlevuar sistematikisht për vlerat termoigrometrike ambientale dhe për t'u siguruar se ruajnë limitet e kushteve ambientale, temperatura 16–20 gradë, lagështia 40–65.

8. Kur lind nevoja operohet si me përmirësimin e kushteve klimatike të ambienteve ashtu edhe me ndërhyrjet për konservimin dhe restaurimin e librave të veçantë. Në këtë operacion parashikohen mjete alternative mikrofilma, mikrofisha, videodisqe, me qëllim ruajtjen edhe në mënyra të tjera të veprës.

9. Operacionet e restaurimit duhet të paraprihen nga dezinfektimi ose dezinfektimet e volumeve të veprave kur këto paraqesin tjetërsime me origjinë biologjike.

10. Në skedën e restaurimit duhet të regjistrohen:

a) veçanësitë e çdo libri dhe duhen përshkruar në mënyrë të detajuar dëmtimet që paraqiten, si dhe ndërhyrjet e mëparshme;

b) operacionet që do të kryhen për të arritur rezultatet e pritshme, me qëllim perfeksionimin e metodave të ndjekura më parë.

11. Në rast të një ndërhyrjeje restauruese në vepër duhet zgjedhur mes ndërhyrjes së plotë ose ndërhyrjes së pjesshme. Rasti i ndërhyrjes së pjesshme aplikohet për restaurimin e librave:

a) që nuk paraqesin probleme në lidhje nuk janë të shqepur;

b) kur veprat janë me interes të veçantë për strukturën e tyre, lashtësinë, vlerën artistike;

c) kur vlerësohet se nuk mund të operohet në mënyrë radikale.

12. Ndërhyrja në këto raste reduktohet në minimum dhe libri nuk pëson tjetërsime, për shkak të çmontimit të plotë, duke mbajtur të paprekshme karakteristikat origjinale të strukturimit.

13. Në rastet kur është e nevojshme shqepja e librit, duhet ndërhyrë me kujdes të veçantë për të evituar humbjen e ndonjë dëshmi/fletë.

14. Përpara se të shqepet një libër, duhen kontrolluar numrat për të evituar gabimet gjatë

rikompozimit të fashikujve. Çdo lloj anomalie shënohet nga bibliotekari përgjegjës.

15. Nuk procedohet gjithnjë me të njëjtin kriter për çdo libër që restaurohet, sepse librat mund të kenë karakteristika e veçanti që kërkojnë edhe ndërhyrje të llojeve të ndryshme.

16. Për fletët parashikohet të përcaktohet përqindja e tretshmërisë së bojës dhe ngjyrave përpara se të procedohet me çfarëdolloj operacioni “në lagështirë” larje, përdorim ngjitësish, fiksuesish. Të tilla operacione duhen kryer vetëm nëse është e domosdoshme dhe duhen ndjekur nga afër. Këshillohen të gjitha masat parandaluese, të cilat ndihmojnë që në fazën e lavazhit të mos humbë asnjë fragment. Sidomos të këshillueshme janë përdorimi i telajos ose i retinos.

17. Pas lavazhit vazhdohet me ngjitjen e fletëve. Nëse fletët kanë nevojë për një shtresë të pjesshme apo të plotë, parashikohet që kjo të bëhet me një pëllhurë letre japoneze transparente, por rezistente, me një penel shumë të butë dhe me një ngjitës riversibël.

18. Ngjeshja e fletëve kryhet në mënyrë të tillë që t'i japë pamjen origjinale sipërfaqes së fletës. Ngjeshja kryhet duke përdorur pllaka mermeri. Kur kjo ngjeshje nuk është e mjaftueshme, duhet përdorur “presimi me goditje” por gjithnjë duke kontrolluar forcën. Gjatë këtij proces duhen ruajtur të gjitha relievat ose zgavrat që gjenden nëpër fleta. Nuk restaurohen, vizatimet ose të tjera shënime, sepse konsiderohen pjesë e historisë së librit.

19. Për një konservim sa më të mirë të librit aplikohet ruajtja e tij në kuti ose mjete të tilla të ngjashme, kur shihet e nevojshme.

20. Parimet e restaurimit të pergamenës janë të njëjta me ato të letrave, me përjashtim të lavazhit, për të cilin përdoren vetëm në raste shumë të domosdoshme. Për kryerjen e tij përdoret një përzierje alkooli etilik me ujë. Ngjeshja duhet të jetë vetëm “shtendosje” dhe kryhet me pllakëza dhe me tirante të vegjël.

21. Në të gjitha këto operacione libri konsiderohet si një vepër arti në kuptimin më të gjerë të fjalës, si vlerë kulturore e ndërthurur me tekst, si vlerë materiale, si vlerë artistike. Për këtë arsye, çdo rast duhet trajtuar si një rast më vete.

22. Për konservimin e librit modern kriteret bazë janë ato të konservimit të librave antikë, duke marrë në konsideratë se librat e prodhuar në shekullin XIX kanë karakteristikat e mëposhtme:



a) janë me një cilësi më të dobët se ato të periudhave paraardhëse;

b) letra është më e lehtë por më e vështirë për t'u ngjitur;

c) për prodhimin e letrës përdoret brumi prej druri me përmbajtje lignine, e cila për këtë arsye rezulton e dobët, e ashpër dhe shumë e prekshme nga nxirja;

ç) lënda e parë antike ishte më e pastër duke paraqitur shpesh një mbrojtje natyrale ndaj aciditetit për shkak të pranisë së substancave alkaline në brumin e letrës.

23. Bibliotekarët duhet të vlerësojnë gjithnjë me kujdes urgjencën dhe nevojën e restaurimit të një libri, duke e konsideruar si masë ekstreme dhe duke e evituar atë, sa më shumë që të jetë e mundur nëpërmjet masave parandaluese që shmangin degradimin e librit.

DH. Norma teknike për konservimin dhe restaurimin e materialeve arkivore

1. Restaurimi i dokumenteve arkivore duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

a) të kryhet vetëm kur është dëmtuar rëndë struktura fizike e dokumenteve arkivore gjë që rrezikon vërtetësinë e dëshmive historike;

b) të jenë verifikuar shkaqet e degradimit të dokumenteve;

c) të ruajë origjinalitetin e dokumentit në raport me formën, strukturën dhe çdo element tjetër të origjinalit;

ç) të jetë dhënë më parë garanci mbi integritetin e informacioneve që përmbajnë dokumentet.

2. Çdo ndërhyrje restaurimi në dokumentet arkivore duhet të miratohet me shkrim nga drejtuesit e arkivave, sipas përgjegjësisë përkatëse institucionale. Kërkesat për restaurime me rëndësi të veçantë, me specifika karakteristike, të lidhjeve, formateve, miratohen më parë nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit.

3. Kërkesa për restaurim duhet të përmbajë:

a) përshkrim analitik të degradimit të dokumentit;

b) shkaqet e degradimit të dokumentit;

c) dokumentacion fotografik mbi gjendjen e dokumentit.

4. Ndërhyrja për restaurim, operacionet që do të ndërmerren, metodologjitë që do të ndiqen, pajisjet, solucionet dhe materialet që do të përdoren, duhet të parashikohen dhe të përshkruhen në detaje në kartelën përkatëse.

5. Ndërhyrja restaurimit duhet të jetë reversibël. Bashkimi i pjesëve që mungojnë duhet kryer me sy të lirë.

6. Janë të lejuara ndërhyrjet, vetëm kur janë shumë të domosdoshme dhe vetëm kur janë të motivuara nga nevojat e një konservimi të mëvonshëm.

7. Duhet hequr të gjitha elementet e shtuara, që në rrjedhën e kohës, kanë tjetërsuar në mënyrë abuzive origjinalitetin e dokumentit. Lejohet përdorimi i pajisjeve që lejojnë restaurimin mekanik të dokumenteve prej letre, gjithnjë vetëm pas vlerësimit të kujdesshëm të gjendjes së konservimit dhe stabilitetit të ndërmjetësve grafikë.

8. Restaurimi në të gjitha fazat e operimit duhet të dokumentohet dhe të përshkruhet në mënyrë të detajuar, për sa u përket metodave të ndjekura, pajisjeve dhe materialeve të përdorura.

9. Ndërhyrjet e restaurimit duhen udhëhequr nga personel i kualifikuar pranë laboratorëve përkatës. Produktet dhe materialet që përdoren, ngjitës, fiksues, solucione, letra, lëkurë, duhet t'u përshtaten kushteve fizike për rezistencë, stabilitet, jetëgjatësi.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të Shtetit ushtron kompetenca mbikëqyrjeje në vendet ku kryhen këto restaurime për të verifikuar përshtatshmërinë dhe konformitetin e ndërhyrjes me normat teknike.

11. Në përfundim të kontrollit përcakton kushtet e konservimit që duhet të ndiqen për ruajtjen dhe konservimin e librave dhe kalendarin e kryerjes së kontrolleve për verifikimin e zbatimit të kushteve të konservimit.

III. KRITERET E NDËRHYRJES NË PASURITË KULTURORE

1. Ndërhyrjet në pasuritë kulturore janë të një përgjegjësie të veçantë, për shkak të vlerave historiko-kulturore dhe artistike të papërsëritshme që këto objekte mbartin. Duke qenë se çdo ndërhyrje, prek substancën e pasurisë kulturore, duhet të motivohet si rruga e vetme e mundshme për të mundësuar ruajtjen dhe për të mos rrezikuar dëmtimin e mëtejshëm të saj.

2. Ndërhyrjet në pasuritë kulturore, i përmbahen thelbit tradicional/konservativ, duke respektuar fazat e ndërtimit dhe duke shmangur sa më shumë ndërhyrjet e reja.



3. Ndërhyrjet në pasuritë kulturore duhet të kryhen pas një kërkimi dhe vëzhgimi sa më të gjerë të pasurisë kulturore ku do të ndërhyhet. Vetëm një njohje të thellë dhe të hollësishme të pasurisë kulturore në të gjitha aspektet e tij historike, artistike, e të qëndrueshmërisë statike dhe strukturore mundëson të arrihet zgjidhje shkencore për ruajtjen e saj.

4. Ndërhyrjet në pasuritë kulturore duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë të gjitha periudhave të së kaluarës të dëshmuara në to.

5. Kryerja e ndërhyrjeve në pasuritë kulturore duhet të përmbushë kriteret, si vijon:

a) Ndërhyrjet duhet të paraprihen nga historiku i pasurisë kulturore dhe i ndërhyrjeve/gërmimeve, nëse ka të tilla, nga studimi i kujdesshëm i gjendjes së konservimit nëpërmjet studimit arkeometrik, fotografimit/dokumentimit të gjendjes para ndërhyrjes, si dhe analizat e materialeve të ndërtimit, analiza strukturore, nëpërmjet të cilave do të njihen:

i. vetitë fiziko-mekanike dhe përbërja kimike e materialeve të ndërtimit, përbërja strukturore, shkaqet dhe rrugët e dëmtimit të veprës apo pasurisë kulturore;

ii. fazat e ndryshme të ndërhyrjes ndër vite, modifikime, shtesa, ndryshime të mundshme në strukturën, formën, pamjen e pasurisë kulturore;

iii. bashkëveprimi me mjedisin/peizazhin kulturor që rrethon pasurinë kulturore dhe materialet e përdorura, në mënyrë që të mundësohet një ndërhyrje e saktë, të sigurohet përcjellja e trashëgimisë për brezat e ardhshëm dhe të nxirren të dhëna për studime në të ardhmen në fusha përkatëse, si teknologji, histori, shkëmbime dhe influenza kulturore.

b) teknikat e përdorura në proceset sipas kapitullit I, pika 4, duhet të respektojnë parimin e rritrajtueshmërisë, të lejojnë në të ardhmen ndërhyrje të tjera me karakter ruajtës, konservues apo restaurues në objekt;

c) specialitetet arkeolog, konservues dhe restaurator i pasurive kulturore arkeologjike duhet të jenë pjesë e pandarë e ekipit të punës në gërmimin, konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore arkeologjike;

ç) gjatë eksplorimeve arkeologjike tokësore ku normat e rikuperimit dhe dokumentimit hyjnë në mënyrë më specifike në kuadrin e normave të lidhura me metodologjinë e gërmimit, për sa i

përket restaurimit, hetohen të gjitha dokumentimet dhe faktet, që gjatë operacionit të gërmimit, garantojnë konservimin e menjëhershëm të objekteve të zbuluara, sidomos të atyre më delikate duke mundësuar kështu mbrojtjen dhe restaurimin përfundimtar të objektit/objekteve.

d) lëvizja e objekteve nga vendi ku ato ruhen apo ekspozohen në një vend tjetër të jetë në përputhje me ligjin nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë". Në çdo rast lëvizja e veprave kryhet pas hartimit të një projekti të hollësishëm, shoqëruar nga kartelat e gjendjes fizike të veprës dhe procedurave përkatëse.

6. Ndërhyrjet në pasuritë kulturore dokumentohen me shkrim si dhe me material fotografik/ video. Ndërhyrjet paraprihen detyrimisht nga procesi i studimit dhe përmbillen me botimin. Proces i studimit, projektimit dhe i ndërhyrjeve do të jetë konform vendimit të Këshillit të Ministrave, "Për studimin, projektimin, zbatimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e pasurive kulturore".

7. Të gjitha ndërhyrjet në pasuritë kulturore paraqiten në kartelat përkatëse të pasurive kulturore, të cilat administrohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore.

IV. MODELET E NDRËHYRJEVE NË PASURITË KULTURORE

Ndërhyrjet restauruese mund të ndahen, për nga aspekti tipologjik, në disa lloje/modele, në varësi të problematikës që shtrijnë dhe të zgjidhjes së tyre. Modelet e ndërhyrjeve në pasuritë kulturore janë si vijon:

A. Punimet e mirëmbajtjes

1. Punimet e mirëmbajtjes së vazhdueshme janë punimet konservuese që synojnë mënjanimin e degradimit të pjesëve të monumentit dhe shmangien eventuale të dëmtimeve të mëtejshme për shkak të defekteve që mund të shfaqen në struktura, elemente dhe materiale të veçanta të monumenteve. Në këtë kuadër, mbajtja në gjendje të mirë përdorimi, funksioni apo vizitimi është në dobi të pasurisë kulturore.

2. Mbikëqyrja e vazhdueshme e monumenteve pakëson nevojën e punimeve të mirëmbajtjes dhe të konservimit. Punimet e mirëmbajtjes kërkojnë angazhimin e mjeshtërve të ndërtimit të aftë dhe me përvojë në të tilla punime. Sugjerohet monitorimi periodik i pasurive kulturore në bazë të disa indikatorëve, sipas specifikave të vlerave që ato



paraqesin në bazë të një planifikimi në kohë dhe përcaktimit të përgjegjësi.

B. Restaurimi çlirues

1. Qëndrimi ndaj shtresave që i janë bërë pasurisë kulturore gjatë jetës së saj shumëshekullore është një nga problemet kryesore të restaurimit të pasurive kulturore të arkitekturës.

2. Gjykimi për këtë duhet bërë mbi bazën e studimit tërësor të pasurisë kulturore dhe përcaktimit të vlerave të secilës shtese si dhe duhet të mos jetë vetëm rezultat i mendimit të autorit të projektit të restaurimit por duhet të jetë rezultat i një gjykimi kolegjial.

3. Është e nevojshme të kihet parasysh se largimi i shtesave nuk përbën qëllimin themelor të ndërhyrjeve restauruese, por një aspekt të tyre kur kjo shihet e dobishme për monumentin. Restaurimi çlirues nuk bëhet për të pasur monumentin në gjendjen fillestare apo në njësinë e stilit. Ai ka për qëllim nxjerrjen në pah të vlerave të vërteta të monumentit të fshehura nën shtesa, të cilat nuk përbëjnë ndonjë interes për monumentin apo ansamblin.

4. Procesi i gjykimit të shtesave në mënyrë kritike për vlerat e fazave të ndryshme të monumentit duhet bërë në disa drejtime. Duhet verifikuar nëse shtesat paraqesin vlera dokumentare në drejtim të zhvillimit apo ndryshimeve të zgjidhjes funksionale, në drejtim të teknikës së ndërtimit si mënyrë e si kronologji absolute apo relative, në drejtim të nivelit të ndërtimeve dhe, nëse përbën shembull të vetëm në këto drejtime apo është një ndër shumë të tjerë e vështuar me kufij të gjerë e të ngushtë të shtrirjes kohore dhe territoriale.

C. Restaurimi plotësues

1. Plotësimi i pjesëve të monumentit që mungojnë përbën anën e kundërt të restaurimit çlirues dhe paraqet një aspekt po aq të rëndësishëm që haset gati gjithnjë i pandarë nga ai.

2. Një grup të parë plotësimesh përbëjnë elementet e reja që futen për arsye përforcimi, përdorimi i të cilave kushtëzohet nga nevoja për masa të tilla në dobi të ruajtjes së monumentit.

3. Një aspekt tjetër përbën plotësimi mbi bazën e pjesëve që ruhen të lëvizura apo të rrënuara që në rastin më të shumë të përputhet me anastilozën.

4. Një grup tjetër përbëjnë zëvendësimet e pjesëve të tjetërsuara dhe grupi i fundit përbën plotësimin e pjesëve që mungojnë te monumenti.

5. Kusht i domosdoshëm për të gjitha rastet është sigurimi i një dokumentacioni të plotë që gjen ballafaqim dhe vërtetim te monumenti. Është e detyrueshme që çdo ndërhyrje të ndalet aty ku fillon hipoteza.

Ç. Rindërtimi

1. Restaurimi rindërtues, i marrë në kuptimin e gjerë të fjalës, parimisht do të përbënte një veprim të ndaluar përderisa nuk mund të justifikohet ndërtimi i një ndërtese apo monumenti të arkitekturës të humbur. Një ndërtese e rindërtuar përbën një kopje që, sado besnike, nuk është e para dhe mbetet një falsifikim.

2. Janë pikërisht përmasat e plotësimit që kërkohet të kryhet në një ndërtesë, që e bëjnë këtë ndërhyrje jo më një plotësim por një rindërtim.

3. Një ndërhyrje restauruese rindërtuese e një pjesë të konsiderueshme të monumentit do të lejohej vetëm atëherë, kur për shkak të mungesave cenohet tërësia e monumentit në aspektin e qëndrueshmërisë së zhvillimit të funksionit në të ose kur kemi të bëjmë me mungesa të cilat dëmtojnë së tepërmi ansamblin në të cilin bëjnë pjesë.

4. Një rast më vete përbëjnë ndërtimet që mungojnë në një kompleks monumental apo ansambël arkitektonik/urban të qendrave historike, sidomos kur këto rrënohen për veprime forcash të natyrës, për raste zjarresh ose raste të shkatërrimit njerëzor apo luftë. Në të tilla raste, gjithnjë mbi bazën e dokumentimit të plotë dhe gjykimit mbi domosdoshmërinë e rindërtimit të tij, në vlerat e mjedisit monumental, ndërmerret restaurimi. Në këto raste, pavarësisht nga shkalla e rrënimit, pjesor apo tërësor restaurimi rindërtues u përmbahet, në anën e jashtme, vëllimeve dhe trajtimit të dikurshëm, ndërsa në brendësi për sa lejon vendi, mund të ndryshohet organizimi i dikurshëm.

5. Në çdo rast gjykimi për këtë lloj restaurimi duhet të mbështetet në vendim kolegjial dhe qasje ndërdisiplinore.

D. Ndërhyrje përforcuese

1. Ndërhyrjet në përforcimin e strukturave dhe elementeve të tjera të monumentit janë më të përdorshmet që më mirë se çdo gjë tjetër përputhen me qëllimin e ruajtjes së pasurisë kulturore dhe vlerave që ajo mbart. Ndërhyrjet përforcuese duhet të mos cenojnë vlerat që pasuritë kulturore mbartin.



2. Këto ndërhyrje nisin me mirëmbajtjen e vazhdueshme dhe deri në masat e përforcimit rrënjësor të strukturave dhe elementeve të veçanta të tij. Ndërhyrje përforcuese janë realizuar dhe përgjatë shekujve në ndërtesa në përdorim që paraqitnin dëmtime dhe mund të rrezikonin shembjen. Restauratorët duhet që të mos përpigjen që përforcimet e reja që bëhen të duken si pjesë origjinale, megjithëse duhet dhe të përpigjen që përforcimet të mos jenë në dukje. Kur kjo është e pamundur atëherë zgjidhja më e mirë është përdorimi i një përforcimi me teknikat e kohës që tregon qartë arsyen për të cilën është vendosur se sa një imitim stilistik për t'u bërë pjesë e veprës.

3. Për marrjen e masave përforcuese sa më të frytshme dhe me prekje sa më të vogël të vlerave është e domosdoshme të studiohen dhe të gjenden shkaqet e dëmtimeve dhe vetëm pas kësaj të projektohen ndërhyrjet përforcuese. Në rastet kur gjendja e monumentit paraqitet me rreziqe në drejtim të qëndrueshmërisë, merren masa të përkohshme përforcimi, si puntelimi i përkohshëm deri sa të realizohen ndërhyrjet përfundimtare.

Dh. Transporti i monumenteve

1. Çdo monument është i lidhur për vetë ngjarjet historike të ndërtimit dhe të jetës së tij e të shoqërisë me vendin në të cilin është ngritur. Vlerat e arkitekturës së jashtme janë të pandara nga mjedisi natyror apo arkitektonik në të cilin është krijuar. Në të tilla rrethana, shkëputja e monumentit, transporti i tij dhe rindërtimi i tij me të njëjtat materiale në një kontekst tjetër nuk duhet të lejohet.

2. Mund të lejohet transporti i monumentit si e vetmja formë e ruajtjes së tij dhe në këto raste nuk lidhet me gjendjen e monumentit por me mjedisin që e rrethon. Kjo ndodh kur monumenti nuk mund të konservohet në vendin e vet, për shkak të rrethanave të vetë terrenit mbi të cilin ndodhet dhe të mjedisit rrethues. Transporti bëhet në dy mënyra, nëpërmjet lëvizjes tërësore, varianti më i favorshëm kur është e mundur ose në pjesë të mëdha dhe nëpërmjet çmontimit në elementet më të vogla përbërëse.

E. Restaurimi i restaurimeve

1. Një ndërhyrje e tillë përbën një problem më vete të teorisë së restaurimit e parë në dy raste të veçanta.

2. Rasti i parë, ai i trajtimit të rindërtimeve të kryera në monument duke mos pasur si qëllim

restaurimin e tij në kuptimin e dy shekujve të fundit, përbën rastin e paraqitur të restaurimi çlirues nga shtesat dhe ndryshimet e monumentit dhe plotësimet e nevojshme që lindin në këtë rast.

3. Rasti i dytë lidhet me restaurimet që i janë bërë monumentit në të kaluarën të cilat sot gjykohen të dëmshme, të paarritura. Edhe këto restaurime përgjithësisht përbëjnë një dokumentim të kohës së tyre dhe të vetë ecures së restaurimeve në kohë. Në këto raste, përherë mbi bazën e gjykimit kritik vendoset që të ndërhyrjet për restaurim shkencor për vlerësim të gjithanshëm të monumentit. Një gjë e tillë nuk duhet bërë kur rasti paraqet rëndësi dhe vlera dokumentare për një histori të restaurimit.

VENDIM

Nr. 1108, datë 28.12.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 143, DATË 13.2.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PROCEDURAT PËR LËSHIMIN E AUTORIZIMIT, PËR SUBJEKTET E RINDËRTIMIT DHE PËR PËRJASHTIMIN NGA TATIMI MBI VLERËN E SHITUAR TË FURNIZIMIT TË MALLRAVE E SHËRBIMEVE, PËR QËLLIME TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 53, shkronjat “I” e “II”, dhe 56, pika 28, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 143, datë 13.2.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shkronja “d”, e nenit 4, hiqet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama



VENDIM

Nr. 1116, datë 29.12.2020

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE
NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
QEVERINË E REPUBLIKËS SË
KROACISË, PËR DËMET E
SHKAKTUARA NGA TËRMETI
I DATËS 29.12.2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë për qeverinë e Republikës së Kroacisë, në masën 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) euro, për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 29.12.2020.

2. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në programin “Përfaqësitë diplomatike jashtë vendit”, në zërin “Shpenzime korrente”, t’i shtohet kundërvlera në lekë e fondit prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) eurosh, për qëllimin sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

4. Ngarkohen Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë